



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 09.03.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.03.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NNP WENDA" për aktivitetin: "Ndertimi i salles se edukates fizike ne shkollen e Busise" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9179-521 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "NNP WENDA" e datës 06.03.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i salles se edukates fizike ne shkollen e Busise" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9179-521, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 02.03.2020*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. **Vërtetohet** *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 02.03.2020*;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "NNP WENDA" me datë 06.03.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i salles se edukates fizike ne shkollen e Busise" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9179-521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 09.03.2020 dhe 10.03.2010 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar dispozitat ligjore te LPP-ik, pikerisht nenin 1 dhe 2 te LPP-se jane plotesisht te pa bazuara pasiqe te gjitha veprimet gjate procesit te vleresimit jane bere ne harmoni me te njejtat.

Duke filluar nga pretendimi se ne pjesen e puneve te makinerise tenderuesi i propozuar per dhenje te kontrates nuk ka vendosur çmim per njesi ne pozicionet 1.7 dhe 2.6 i sqarojme se keto dy pozicione ne menyre te qarte jane te cekura ne perqindje nga totali i pozicioneve te gypave dhe Autoriteti Kontraktues ka verifikuar se çmimi i vendosur ne ato pozicione eshte ne

harmoni me perqindjen e kerkuar (te 1.7 kemi totali $1.1-1.6=1,896.00 \times 20\%=379.20$ € dhe te pozicioni 2.6 kemi totali $2.1-2.5=1,295.20 \times 30\%=388.56$ €).

Pretendimi tjetër lidhur me datat e raportit të vleresimit dhe Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues janë të nderlidhura me situatën e krijuar buxhetore (mungesa e aprovimit të Ligjit për Buxhetin) dhe është dashur të presim aprovimin për publikim nga Zyrtaret kompetent për financa, sipas të cileve mund të publikohet Njoftimi për Vendimin e AK-se, por nuk mund të publikohet Njoftimi për dhenje të kontratës pa alokimin e mjeteve. Pra nuk ka të bëjë me asnjë lloj pritje apo qëndrimi në tavolinë, por ka të bëjë me situatën e krijuar buxhetore.

Pretendimi vijues se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 kur ka kërkuar se cili nga ekspertët është menaxher i projektit nuk ka të bëjë me asnjë dokument që nuk mund të saktësohet se ka ekzistuar para dorëzimit të tenderit, por ka të bëjë me deshmite e derguara të stafit profesional në tenderin e tij dhe nuk i është kërkuar asnjë plotësim për ndonjë anëtar që nuk ka deshmë në tenderin e tij;

-Pretendimi tjetër se tenderuesi i propozuar për kontratë nuk ka dërguar sqarimet me kohë është plotësisht i pa bazuar, pasi që i njëjti ka dërguar sqarimet ditën e nesërme, mirepo nuk ka pasë mundësi teknike të shkarkohen nga platforma E Prokurimi dhe për këtë i është kërkuar që të njëjtat të dërgoj edhe nëpërmes emailit zyrtar (për këtë ekziston deshmia e njoftimit nga Platforma E Prokurimi dhe komunikimet pas të njëjtit);

-Pretendimi se tenderuesi i propozuar për dhenje të kontratës nuk ka ofruar deshmë të mjaftueshme lidhur me çmimin jonorimalisht të ulet nuk është i bazuar për faktin se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarimet për çmimin total të ofruar e jo për pozicione. Autoriteti Kontraktues ka pranuar sqarimet dhe i ka konstatuar si pjesërisht të pranueshme dhe për këtë ka rekomanduar rritjen e sigurimit të ekzekutimit prej 10% në 20%, e që paratet veprim të ligjshëm. Ky veprim është poashtu në harmoni me kërkesat e nenit 1 të LPP-ik dhe kriteret e dhenjes nga FDT-ja, pasi që është propozuar për dhenje të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulet.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

